

## AMF nis fushatën për edukimin financiar me studentët e Universitetit “Aleksandër Moisiu”, Durrës

### Vështrim mbi tregjet

- Zhvillimet e Tregut të Sigurimeve në Shqipëri për periudhën janar-shtator 2017
- Zhvillimet e Tregut me Pakicë të Letrave me Vlerë të Qeverisë për periudhën janar-shtator 2017

### Zhvillime të tjera

- Zhvillohet konferenca “Sfidat aktuale për tregjet e sigurimeve dhe mbikëqyrjen në Evropën Qendrore, Lindore dhe Juglindore”
- Zhvillohet takimi i Nënkomitetit Bashkimi Evropian – Shqipëri “Tregu i Brendshëm dhe Konkurrenca, duke përfshirë mbrojtjen e konsumatorit dhe shëndetit”
- Takimi i 6-të i forumit të rregullatorëve të tregjeve të kapitalit të vendeve të Komitetit për Bashkëpunim Ekonomik dhe Tregtar të Organizatës së Bashkëpunimit Islamik
- Mbrojtja e Konsumatorit dhe Stabiliteti Financiar me mbikëqyrjen me Bazë Rreziku dhe proporcionalitetin

### Edukimi i Konsumatorit

- Rregullimi i tregjeve financiare dhe mbikëqyrja e sigurimeve gjithëpërfshirëse

### Lajme Ndërkombëtare

- Maqedoni
- Serbi
- Turqi
- Vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore

Mbrojmë Konsumatorët - Promovojmë Tregjet - Zbatojmë Ligjin

## AMF nis fushatën për edukimin financiar me studentët e Universitetit “Aleksandër Moisiu”, Durrës

Iniciativa për të rritur edukimin financiar, e cila filloi me studentët e Universitetit “Aleksandër Moisiu”, do të shtrihet më gjerë, për të përcjellë informacione të kuptueshme për të gjithë publikun, në mënyrë që në një të ardhme të afërt, produktet financiare, si sigurimet, fondet vullnetare të pensioneve, apo fondet e investimit të mos jenë më detyrime për t'u përmbushur apo mekanizma financiarë të largët, por të shndërrohen në pjesë të jetës sonë ekonomike.



Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i AMF-së, Z. Ervin Koçi dhe Dekania e Fakultetit të Biznesit, Znj. Azeta Tartaraj



Gjatë fushatës për edukimin financiar me studentët e Universitetit “Aleksandër Moisiu”, Durrës

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare nisi më datë 25 tetor 2017, ora 11:00 fushatën për edukimin financiar në lidhje me tregjet nën mbikëqyrje, duke zhvilluar një leksion të hapur me studentët e Fakultetit të Biznesit në Universitetin “Aleksandër Moisiu”, Durrës. Aktiviteti, si pjesë e strategjisë që po zbatohet nga AMF “Për rritjen e besimit të konsumatorit/investitorit në tregjet financiare nën mbikëqyrje”, do të pasohet edhe nga aktivitete të tjera, ku grupi i parë i fokusuar janë studentët. Gjatë aktivitetit u nënshkrua një marrëveshje bashkëpunimi ndërmjet Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare dhe Universitetit “Aleksandër Moisiu”, Durrës nga Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i AMF-së, Z. Ervin Koçi dhe Dekania e Fakultetit të Biznesit, Znj. Azeta Tartaraj.

Në fjalën e mbajtur me këtë rast, Z. Koçi theksoi se edukimi financiar në lidhje me tregjet nën mbikëqyrjen e AMF-së, për të rritur njohuritë dhe ndërgjegjësimin për shërbimet që ofrohen është shndërruar në një nga prioritetet e punës së Autoritetit. Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv i AMF-së tha se: *“Iniciativa për të rritur edukimin financiar, e cila filloi me studentët e Universitetit “Aleksandër Moisiu”, do të shtrihet më gjerë, për të përcjellë informacione të kuptueshme për të gjithë publikun, në mënyrë që në një të ardhme të afërt, produktet financiare, si sigurimet, fondet vullnetare të pensioneve, apo fondet e investimit të mos jenë më detyrime për t'u përmbushur apo mekanizma financiarë të largët, por të shndërrohen në pjesë të jetës sonë ekonomike”.*

Gjatë aktivitetit, studentëve dhe pedagogëve iu shpërnda një pyetësor, si pjesë e një fushate anketimesh, e nisur nga AMF për të identifikuar njohuritë dhe adresuar më mirë kërkesat për edukim financiar, në lidhje me tregjet nën mbikëqyrjen e Autoritetit. Me qëllim rritjen e edukimit financiar dhe mbrojtjen e konsumatorit, AMF ka krijuar një drejtori të posaçme si pjesë e strukturës së re, duke i dhënë më shumë peshë mbrojtjes konsumatore, por edhe rritjes së informimit e ndërgjegjësimit për tregjet nën mbikëqyrje.

# VËSHTRIM MBI TREGJET

## Zhvillimet e Tregut të Sigurimeve në Shqipëri për periudhën janar-shtator 2017

Të ardhurat nga primet e shkruara bruto të sigurimit gjatë periudhës janar-shtator 2017 kapën vlerën mbi 12.03 miliardë lekë, ose 11.45% më shumë se gjatë periudhës janar-shtator 2016. Gjatë periudhës janar-shtator 2017, numri i kontratave të sigurimit të lidhura arriti në 932,106 me një rritje prej 15.23% krahasuar me periudhën janar-shtator 2016.

Një tjetër tregues i ecurisë së tregut, dëmet e paguara bruto, në total, regjistruan një rritje me 26.07% në krahasim me periudhën janar-shtator 2016. Pjesa më e madhe e dëmeve të paguara bruto i përket sigurimit motorik me rreth 2.24 miliardë lekë, apo 60.23% të totalit të dëmeve të paguara bruto.

### Sigurimi i Jo-Jetës

Sigurimi i Jo-Jetës u rrit me 10.29% gjatë periudhës janar-shtator 2017, krahasuar kjo me periudhën janar-shtator 2016.

### Sigurimi i detyrueshëm motorik

Primet e sigurimit të detyrueshëm motorik vlerësohet të kenë arritur vlerën rreth 7.38 miliardë lekë gjatë periudhës janar-shtator 2017, duke shënuar një rritje prej 11.06% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

Sigurimi i detyrueshëm motorik gjatë periudhës raportuese përbën 61.38% të tregut të sigurimeve.

### Klasa të tjera në sigurimet e Jo-Jetës

Ndër klasat e tjera kryesore të sigurimit të Jo-Jetës veçohen:

■ Sigurimi i aksidenteve, sigurimi i shëndetit dhe sigurimi i përgjegjësive të përgjithshme të cilat së bashku zunë 11.28% të tregut të Jo-Jetës;

■ Zjarri, forcat e natyrës dhe dëmtime të tjera në pronë të cilat zunë 12.57 % të tregut të Jo-Jetës.


### Sigurimi i Jetës

Primet e shkruara bruto në sigurimin e Jetës u rriten me 28.85% krahasuar me periudhën janar-shtator 2016. Pjesa më e madhe e primeve të shkruara bruto i përket sigurimit “Jetë debitori” e cila përbën 63.67% të sigurimit të Jetës.

Primet e sigurimit të detyrueshëm motorik vlerësohet të kenë arritur vlerën rreth 7.38 miliardë lekë gjatë periudhës janar-shtator 2017, duke shënuar një rritje prej 11.06% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

## Ndarja e tregut të sigurimeve, janar-shtator 2017

Grafiku më poshtë paraqet ndarjen e volumit total të primeve të shkruara bruto sipas grupeve kryesore.




## Zhvillimet e Tregut me Pakicë të Letrave me Vlerë të Qeverisë për periudhën janar-shtator 2017

Volumi i tregut sekondar të letrave me vlerë të Qeverisë gjatë periudhës janar-shtator 2017 u dominua në masën 71.41% nga transaksionet në instrumente afatshkurtër (bono thesari) dhe pjesa tjetër prej 28.59% ishin instrumente afatgjatë (obligacione). Përsa i përket numrit të transaksioneve, 93.20% e të gjitha transaksioneve të tregut sekondar të letrave me vlerë të Qeverisë, i takojnë transaksioneve të kryera me bono thesari.

Të dhënat statistikore të tregut me pakicë të letrave me vlerë të Qeverisë gjatë periudhës janar-shtator 2017 flasin për një dominim të transaksioneve “Blerje në tregun primar” dhe “Shlyerje e vlerës nominale në maturim” përkatësisht me 61.05% dhe 29.08% kundrejt volumit të përgjithshëm.

Pjesëmarrja në tregun sekondar të letrave me vlerë të Qeverisë, për këtë periudhë dominohet nga investitorët individualë, të cilët kryejnë 99.56% të të gjitha transaksioneve në këtë treg.

### Letra me vlerë të Qeverisë për periudhën janar-shtator 2017



Volumi i tregut sekondar të letrave me vlerë të Qeverisë gjatë periudhës janar-shtator 2017 u dominua në masën 71.41% nga transaksionet në instrumente afatshkurtër (bono thesari) dhe pjesa tjetër prej 28.59% ishin instrumente afatgjatë (obligacione).

Vihet re një ulje në vlerë absolute e totalit të transaksioneve të llojit B dhe C të marra së bashku me rreth 1,781 milionë lekë, krahasuar me të njejtën periudhë të një viti më parë.

## Dy grupet e transaksioneve B dhe C

Transaksioni i llojit **B** “**Shitje nga portofoli i ndërmjetësit financiar**” gjatë periudhës janar-shtator 2017, ka pasur një ulje prej 985 milionë lekë ose 21.26% krahasuar me periudhën janar-shtator 2016. Gjithashtu dhe numri i transaksioneve është ulur në masën 34.60%.

Transaksioni i llojit **C** “**Blerje para afatit të maturimit**” gjatë periudhës janar-shtator 2017 ka pasur ulje prej 769 milionë lekë ose 27.80% dhe gjithashtu, një ulje në numrin e transaksioneve në masën 20.90%, krahasuar me periudhën janar-shtator 2016.

Vihet re një ulje në vlerë absolute e totalit të transaksioneve të llojit B dhe C të marra së bashku me rreth 1,781 milionë lekë, krahasuar me të njejtën periudhë të një viti më parë.

### Tregu me Pakicë i Letrave me Vlerë të Qeverisë

Lloji i transaksionit	Vlera nominale (në mln Lekë)		Ndryshimi (në %)
	2016	2017	'17/'16-1
janar-shtator			
<b>B Shitje nga portofoli i ndërmjetësit financiar</b>	<b>4,632.77</b>	<b>3,647.83</b>	<b>(21.26)</b>
<i>Individë</i>	3,838.87	3,253.93	(15.24)
<i>Persona juridikë</i>	793.90	393.90	(50.38)
<b>C Blerje para afatit të maturimit</b>	<b>2,863.99</b>	<b>2,067.68</b>	<b>(27.80)</b>
<i>Individë</i>	2,382.09	2,050.68	(13.91)
<i>Persona juridikë</i>	481.90	17.00	(96.47)

## ZHVILLIME TË TJERA

### Zhvillohet konferenca “Sfidat aktuale për tregjet e sigurimeve dhe mbikëqyrjen në Evropën Qendrore, Lindore dhe Juglindore”

Autoriteti i Tregjeve Financiare të Austrisë, FMA zhvilloi në datat 12-13 tetor 2017, në Vjenë, Austri, konferencën me temë “Sfidat aktuale për tregjet e sigurimeve dhe mbikëqyrjen në Evropën Qendrore, Lindore dhe Juglindore”.

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare u përfaqësua nga Drejtori i Përgjithshëm Ekzekutiv, Z. Ervin Koçi dhe Nëndrejtorja Ekzekutive, Znj. Mimoza Kaçi. Drejtuesit e lartë të AMF-së prezantuan ecurinë e tregut të sigurimeve, si dhe sfidat e prioritetet për zhvillimin e mëtejshëm të tij.

Znj. Kaçi ishte pjesë e njërit prej paneleve të diskutimit me temë “Një treg i liberalizuar për sigurimin motorik - si mund të funksionojë në praktikë?” Nëndrejtorja Ekzekutive e AMF-së bëri një pasqyrim të gjendjes aktuale të tregut të sigurimeve në vendin tonë, duke theksuar se 62% e totalit të primeve vijnë nga sigurimi i detyrueshëm. Znj. Kaçi bëri një përshkrim të ecurisë së tregut ndër vite, ndërsa foli edhe për sfidat kryesore që do të sillte një liberalizim i mundshëm i sigurimit motorik në Shqipëri. Në konferencën dy-ditore u organizuan disa panele të tjera diskutimi me tema të ndryshme, si:

- Pas *Solvency II* – cila do të jetë e ardhmja e biznesit dhe mbikëqyrjes së sigurimeve në Evropë?;
- “*Big Data*” dhe ndryshimet klimatike – A ka të ardhme për sigurimin nga katastrofat?;
- Modele dhe produkte të biznesit të sigurimeve – vende të ndryshme, strategji të ndryshme;
- Fokusi te mbrojtja e konsumatorit – çfarë duhet të dijë i siguruari?

Në këtë konferencë morën pjesë rreth 80 drejtues të autoriteteve mbikëqyrëse dhe të kompanive të sigurimit nga vendet e Evropës Qendrore, Lindore dhe Juglindore.

### Zhvillohet takimi i Nënkomitetit Bashkimi Evropian – Shqipëri “Tregu i Brendshëm dhe Konkurrenca, duke përfshirë mbrojtjen e konsumatorit dhe shëndetit”

Komisioni Evropian zhvilloi në datë 17 tetor 2017, në Bruksel, takimin e nëntë të Nënkomitetit Bashkimi Evropian – Shqipëri me temë: “Tregu i Brendshëm dhe Konkurrenca, duke përfshirë mbrojtjen e konsumatorit dhe shëndetit”. Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, raportoi mbi përparimin dhe arritjet e institucionit për periudhën 2016 dhe gjashtëmujorin e parë të vitit 2017 për të tre sektorët e mbikëqyrur. Këtë raportim Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare e realizon me pjesëmarrje çdo vit.

Drejtuesit e lartë të AMF-së prezantuan ecurinë e tregut të sigurimeve, si dhe sfidat e prioritetet për zhvillimin e mëtejshëm të tij.

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare raportoi, se gjatë vitit 2016 dhe gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit 2017, konsolidoi punën për hartimin dhe rishikimin e kuadrit ligjor, rregullator e mbikëqyrës, me qëllim përafrimin e mëtejshëm të tij me *acquis* e Bashkimit Evropian në fushën e tregut financiar jobankar, në zbatim të nenit 89 të MSA-së, rekomandimeve të Raportit të Progresit të Komisionit Evropian 2016, si dhe rekomandimeve të Nënkomitetit të Bashkimit Evropian-Shqipëri "Tregu i Brendshëm dhe Konkurrenca", 2016, me synim, përmirësimin e mëtejshëm të këtij tregu, forcimin e mbikëqyrjes dhe të kapaciteteve institucionale.

Ndër sfidat më të rëndësishme të vitit 2016 ishin:

- Vazhdimi i zbatimit të mbikëqyrjes me Fokus Rrezikun në tregun e sigurimevedhe në tregun e fondeve të pensionit;
- Forcimi i mëtejshëm i tregut të fondeve të investimeve nëpërmjet përmirësimit të bazës ligjore, në lidhje me administrimin e rreziqeve me të cilat përballen këto fonde dhe shoqëritë që i administrojnë;
- Nxitja e qëndrueshmërisë në tregjet financiare nëpërmjet përmirësimit të procesit të mbikëqyrjes së konsoliduar, si dhe;
- Forcimi i punës së AMF-së në drejtim të mbrojtjes dhe edukimit konsumator.

Për vitin 2017, si arritje dhe sfida të mëtejshme, u përmendën licencimi nga AMF më datë 3 korrik 2017 i shoqërisë "Bursa Shqiptare e Titujve, ALSE" sh.a., (*Albanian Stock Exchange*) si bursa e parë shqiptare me kapital privat e licencuar në vend, si dhe miratimi i strukturës së re organizative të institucionit në qershor 2017, e cila reflekton më së miri zhvillimin dinamik të tregjeve financiare jo bankare.

### **Takimi i 6-të i forumit të rregullatorëve të tregjeve të kapitalit të vendeve të Komitetit për Bashkëpunim Ekonomik dhe Tregtar të Organizatës së Bashkëpunimit Islamik**

Bordi i Tregjeve të Kapitalit të Turqisë, si sekretariati i forumit të rregullatorëve të tregut të kapitaleve të COMCEC, organizoi më datë 31 tetor 2017 në Stamboll, Turqi takimin e 6-të të Asamblesë së Përgjithshme të këtij forumi. Në këtë takim merrnin pjesë përfaqësues nga autoritetet mbikëqyrëse dhe rregullatore të tregut financiar nga vende të ndryshme si Turqia, Irani, Kuvajti, etj. Gjatë këtij takimi pjesëmarrësit u ftuan të diskutojnë aktivitetet e Task Forcës gjatë vitit 2017, zhvillimet në tregjet financiare, modelin e financës islamike, si dhe programin e punës të Forumit për vitin 2018.

Në forum u prezantuan edhe rezultatet e *research paper* të kryer në 6 shtete lidhur me infrastrukturën e tregjeve financiare, si dhe mundësitë e zhvillimit të mëtejshëm. Gjithashtu, një tjetër prezantim lidhej me paraqitjen e rezultateve nga Task Forca e edukimit financiar, e cila kishte si qëllim përgatitjen e një reviste të quajtur "*Financial Literacy Review*" me informacione të mbledhura nga juridiksione të ndryshme. Në vijim, u diskutuan zhvillimet më të fundit në

Për vitin 2017 si arritje dhe sfida të mëtejshme u përmendën, licencimi nga AMF më datë 3 korrik 2017 i shoqërisë "Bursa Shqiptare e Titujve, ALSE" sh.a., (*Albanian Stock Exchange*) si bursa e parë shqiptare me kapital privat e licencuar në vend, si dhe miratimi i strukturës së re organizative të institucionit në qershor 2017, e cila reflekton më së miri zhvillimin dinamik të tregjeve financiare jo bankare.

sektorin e financave islamike, si dhe një përmbledhje e zhvillimeve të tregjeve të kapitalit në secilin shtet pjesëmarrës.

## **Mbrojtja e Konsumatorit dhe Stabiliteti Financiar me mbikëqyrjen me Bazë Rreziku dhe proporcionalitetin**

Banka Qendrore e Armenisë në bashkëpunim me Shoqatën Ndërkombëtare të mbikëqyrësve në sigurime (*International Association of Insurance Supervisors, IAIS*), Institutin për Stabilitet Financiar (*Financial Stability Institute, FSI*) dhe Autoritetin Evropian për Sigurimet dhe Pensionet Profesionale (*European Insurance and Occupational Pensions Authority, EIOPA*) zhvilluan në datat 3-5 tetor 2017, trajnimin me temë “Mbrojtja e konsumatorit dhe Stabiliteti Financiar me mbikëqyrjen me Bazë Rreziku dhe proporcionalitetin”.

Gjatë trajnimit u trajtuan tema të rëndësishme, si:

1. Aftësia paguese mbi Bazën e Rrezikut dhe stabiliteti financiar, sipas perspektivës së IAIS-it, vendosja e standardeve në kërkesat e kapitalit, absorbimi më i lartë i humbjeve dhe mbikëqyrja makroprudenciale;
2. Aspektet makroprudenciale dhe stabiliteti financiar. U diskutua mbi rolin e sigurimeve në ekonomi, stabilitetin financiar dhe burimin e rrezikut sistemik në sektorin e sigurimeve;
3. Zbatimi i standardeve mbi qeverisjen e korporatave dhe vlerësimi i nivelit të pajtueshmërisë. U diskutua për ICP 5, mbi përshtatshmërinë e personave. Më pas fokusi kaloi gjerësisht tek zbatimi i ICP 7, mbi qeverisjen e korporatave;
4. Zhvillimet e rreziqeve dhe vlerësimi i stabilitetit financiar, sipas perspektivës së EIOPA-s. U diskutua mbi një nga objektivat kryesore të EIOPA-s, stabilitetin financiar, rreziqet e reja dhe tendencat e rrezikut, si dhe për llojet e *stress testeve*;
5. Sjellja e tregut në ndryshimin e tregut të sigurimeve. U prezantuan ICP 18, për ndërmjetësit dhe ICP 19 mbi sjelljen e bizneseve. Fokusi me pas kaloi te përfitimet dhe sfidat e mbikëqyrjes me Bazë Rreziku, kontrolli i brendshëm, strategjitë dhe manualët e mbikëqyrjes;
6. Menaxhimi efektiv i rrezikut dhe kontrollit të brendshëm përmes tre linjave të mbrojtjes. U prezantuan metodat e mbikëqyrjes sipas ICP 9, 10 dhe 11 si dhe tre linjat e mbrojtjes, të cilat janë:
  - Menaxhimi i linjës së biznesit;
  - Menaxhimi i rrezikut dhe funksionet e kontrollit të brendshëm, të drejtorit të riskut (CRO), e drejtorit të pajtueshmërisë (CCO) dhe aktuarit;
  - Auditi i Brendshëm.

Banka Qendrore e Armenisë në bashkëpunim me Shoqatën Ndërkombëtare të mbikëqyrësve në sigurime (*International Association of Insurance Supervisors, IAIS*), Institutin për Stabilitet Financiar (*Financial Stability Institute, FSI*) dhe Autoritetin Evropian për Sigurimet dhe Pensionet Profesionale (*European Insurance and Occupational Pensions Authority, EIOPA*) zhvilluan në datat 3-5 tetor 2017, trajnimin me temë “Mbrojtja e konsumatorit dhe Stabiliteti Financiar me mbikëqyrjen me Bazë Rreziku dhe proporcionalitetin”.



Vëmendje e veçantë iu kushtua dhe kulturës së riskut, disa shembujve të kësaj kulture, si dhe qasjes së mbikëqyrësve dhe të kompanive të sigurimit ndaj kulturës së rrezikut;

7. Vlerësimi i rrezikut duke përdorur mbikëqyrjen e bazuar në rrezik, si dhe Vlerësimi i cilësisë së qeverisjes së siguresve dhe sistemi i menaxhimit të rrezikut. Vëmendje e veçantë iu kushtua kërkesave për përshtatshmëri dhe aftësi sipas direktivës *Solvency II*.

## Takimi i Tetë i Komitetit të Stabilizim – Asociimit BE-Shqipëri

Në datën 4 tetor 2017, u zhvillua në Bruksel Takimi i Tetë i Komitetit të Stabilizim-Asociimit BE-Shqipëri, i cili monitoron zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit. Qëllimi i këtij takimi është shqyrtimi i zhvillimeve legjislative dhe institucionale të Shqipërisë nga takimi i mëparshëm i këtij Komiteti, zhvilluar në qershor 2016 dhe vlerësimi nga pala evropiane i progresit të bërë nga Shqipëria në përmbushjen e angazhimeve që burojnë nga Marrëveshja e Stabilizim Asociimit.

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, në kuadër të këtij takimi, hartoi raportin përkatës duke u fokusuar në zhvillimet që ka pasur tregu financiar jo bankar në aspektin e zhvillimeve legjislative dhe rregullatore, me qëllim përafrimin me *acquis* e BE-së, si dhe ngritjen dhe forcimin e kapaciteteve institucionale.

AMF, si çdo vit, raportoi mbi përparimin dhe arritjet e institucionit për periudhën 2016 dhe gjysmën e parë të vitit 2017 për të tre sektorët e mbikëqyrur. Në takimin e këtij viti, pala evropiane kishte caktuar pikë të veçantë në axhendë, “Programin e Reformave Ekonomike (Rekomandim 3 – Forcimi i mbikëqyrjes në sektorin jo bankar duke rritur kapacitetet e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare.)

---

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, në kuadër të këtij takimi, hartoi raportin përkatës duke u fokusuar në zhvillimet që ka pasur tregu financiar jo bankar në aspektin e zhvillimeve legjislative dhe rregullatore, me qëllim përafrimin me *acquis* e BE-së, si dhe ngritjen dhe forcimin e kapaciteteve institucionale.

---

## Rregullimi i tregjeve financiare dhe mbikëqyrja e sigurimeve gjithëpërfshirëse

Shoqata Ndërkombëtare e Rregullatorëve të Sigurimeve (IAIS) ka publikuar një dokument mbi rregullimin dhe mbikëqyrjen e tregjeve gjithëpërfshirëse të sigurimeve, ku synohet gjetja e mjeteve për përfshirjen në skemat e sigurimeve të shtresave të marginalizuara dhe atyre me të ardhura nën mesataren. Dokumenti shërben si një udhërrëfyes në zbatimin e skemave gjithëpërfshirëse të sigurimeve.

(Marrë me shkurtime e redaktime – pjesa e tretë)

Për të kapërcyer barrierat ndaj tregjeve gjithëpërfshirëse të sigurimeve, sigurimi mund t'i ofrohet konsumatorëve nga një gamë e gjerë siguresish nëpërmjet formave të ndryshme institucionale, për shembull, subjektet fitimprurëse ose jo-fitimprurëse (siç përcaktohet nga mbikëqyrësi i sigurimit ose nga ndonjë organ tjetër kompetent sipas ligjeve kombëtare). Ofruesit mund të përfshijnë (*death-benefit associations* - shoqatat që sigurojnë të ardhurat pas vdekjes), siguresit e ndërsjellë dhe bashkëpunues, siguresit tregtarë dhe mikrosiguresit e dedikuar.

Për të ilustruar mundësitë për ndryshimin e praktikave konvencionale të tregut, jepen shembujt e mëposhtëm për subjektet që mund të ndihmojnë në heqjen e barrierave për përfshirjen në sigurime.

Ofruesit mund të përfshijnë (*death-benefit associations* - shoqatat që sigurojnë të ardhurat pas vdekjes), siguresit e ndërsjellë dhe bashkëpunues, siguresit tregtarë dhe mikrosiguresit e dedikuar.

- Siguresit e mëdhenj të cilët veprojnë në tregun konvencional duke kërkuar të ofrojnë shërbime për segmentin e tregut të nënvleftësuar.
- Siguresit e vegjël, disa prej të cilëve aktualisht mund të ekzistojnë, por janë informalë. Aksesit duhet të jepet për produkte të formalizuara të sigurimit, të ofruara nga siguresit formalë. Krahas kësaj duhet të adresohet edhe informaliteti në sigurime, gjë që mund të kërkojë përgjigje rregullatore që pasqyrojnë përmasat, natyrën dhe kompleksitetin e rreziqeve të përfshira, si dhe nevojën për periudhat e tranzicionit të dizenjuara mirë. Disa juridiksione njohin siguresit e vegjël që janë të përkushtuar për të ofruar shërbime dhe produkte për tregjet me performancë të dobët dhe si rezultat të veprojnë me një licencë që është e kufizuar në fushëveprim dhe nganjëherë quhen "mikrosiguresit e përkushtuar".
- Subjektet, që gjithashtu kanë shërbime financiare jo-sigurimi ose shërbime jo-financiare nëpërmjet shfrytëzimit të marrëdhënieve të tjera me klientët potencialë ose me mekanizmat e ofrimit të shërbimeve aktive, mund të kapërcejnë pengesat. Ka raste kur njësitë e mëdha përfshihen në shërbimet e sigurimit dhe biznesi i sigurimeve është shumë i vogël në krahasim me operacionet e përgjithshme, si për shembull, kompanitë e telekomit që kanë gjetur sukses në ofrimin

Shpeshherë klientët potencialë jetojnë gjeografikisht larg vendit nga ku ofrohen shërbimet e sigurimit dhe mund të emigrojnë në kërkim të punës me periudha sezonale.

e shërbimeve të tjera financiare përmes aparateve dhe rrjeteve telefonike. Shembujt do të përfshinin kooperativat e angazhuara në bujqësi që gjithashtu përfshihen në shërbimet e sigurimit që lidhen me kulturat bujqësore të anëtarit të tyre, ofruesit e shërbimeve shëndetësore që paraqesin përfitime të shërbimeve të sigurimit shëndetësor ose ofruesit e shërbimeve të funeralit që paraqesin rregullime për sigurimin e shërbimit të funeralit.

- **Pilotët.** Ky term i referohet inovacioneve të avancuara përmes eksperimentimit. Disa projekte mund të çojnë në risitë e konfirmuara që pastaj "rriten në mënyrë proporcionale", të tjerët mund edhe të dështojnë. Aktualisht projektet pilote ose inovacionet kryhen nga një gamë e gjerë subjektsh, ndonjëherë me mbështetjen e sponsorëve që mund të sjellin burime të konsiderueshme për projektin. Pilotët e tjera mund të jenë më pak formalë ose më pak të rëndësishëm.

### **Përcaktimi i mikro-sigurimit në dokumentet e IAIS-it**

Shoqata Ndërkombëtare e Rregullatorëve të Sigurimeve (IAIS) e ka përcaktuar "mikro-sigurimin" si sigurim që aksesohet nga pjesa e popullsisë me të ardhura të ulëta, të ofruara nga një sërë subjektsh të ndryshëm, por që drejtohen në përputhje me praktikën e sigurimit përgjithësisht të pranuar (të cilat përfshijnë *International Core Principals*, ICP-të). Kryesisht, kjo do të thotë që risku i siguruar nga një politikë mikro-sigurimi menaxhohet bazuar në parimet e sigurimeve dhe financohet nga primet. Primet mund të jenë të financuara privatisht ose publikisht, por edhe nga kombinimi i të dyjave. Vetë veprimtaria e mikrosigurimit duhet të përfshihet në kuadër të mbikëqyrësit përkatës të sigurimit vendas.

Duhet sqaruar se "mikro-sigurimi" nuk përfshin skemat e mbështetjes sociale të dhëna nga qeveria, pasi kjo nuk financohet nga primet që lidhen me rreziqet dhe përfitimet nuk paguhet nga një fond i përbashkët që menaxhohet në bazë të parimeve të sigurimit dhe rrezikut. Për të njëjtën arsye, mikro-sigurimi nuk përfshin asistencën e ofruar nga qeveritë në rastet e fatkeqësive natyrore (përmbytjet, zjarret, tërmetet) në komunat me të ardhura të ulëta. Megjithatë, mundet që shteti të përcaktojë se ekziston nevoja për të sponsorizuar aksesin në mikro-sigurim për shtresat e marginalizuara, nëpërmjet praktikave të rishpërndarjes. Ka raste kur shteti luan një rol më të fuqishëm në skemat e financimit të plotë, por këto do të konsideroheshin si mikro-sigurim vetëm nëse drejtohen sipas parimeve të sigurimit.

## Maqedoni

[www.xprimm.com](http://www.xprimm.com)

Të ardhurat e siguruesve në Maqedoni u rritën me 3.13% në krahasim me vitin e kaluar, sipas të dhënave të gjashtëmujorit të parë të vitit 2017, duke arritur në 4.62 miliardë Dinarë (monedha lokale MKD), ose rreth 74.95 milionë euro, sipas të dhënave të publikuara nga Agjencia e Mbikëqyrjes së Sigurimeve. “Në kushtet e paqartësive politike dhe korrektimit të rritjes së GDP-së, kompanitë e sigurimeve arritën të ruajnë një trend pozitiv. Kompanitë e sigurimit të Jo-Jetës gjeneruan të ardhura prej 64.48 milionë euro, me një rritje prej 1.23% krahasuar me vitin e kaluar, ndërsa kompanitë e Jetës siguruan të ardhura prej 10.47 milionë euro, me një rritje prej 16.56% krahasuar me një vit më parë,” u shpreh Klime Poposki, drejtues i Agjencisë së Mbikëqyrjes së Sigurimeve të Maqedonisë për “Xprimm”.

## Serbi

[www.xprimm.com](http://www.xprimm.com)

Tregu i sigurimeve në Malin e Zi mbetet më i vogli mes 17 vendeve të Evropës Qendrore dhe Lindore sa i përket primeve të shkruara bruto, me të ardhura prej 40 milionë euro për gjashtëmujorin e parë të vitit 2017, me një rritje prej 3.5%. Sipas të dhënave të Agjencisë së Mbikëqyrjes së Sigurimeve të Malit të Zi (ISA), primet e shkruara bruto për segmentin e Jo-Jetës përbëjnë 83.5% të tregut, me të ardhura prej 33.4 milionë euro. Ndërsa në anën tjetër, segmenti i Jetës pësoi një rritje vjetore me 7.3%, duke sjellë të ardhura prej 6.6 milionë euro.

## Turqi

[www.xprimm.com](http://www.xprimm.com)

Gjysma e parë e vitit 2017 solli një rritje prej 12% në tregun e sigurimeve në Turqi, me të ardhura prej 23.1 miliardë TRY (Lira Turke, monedha lokale) ose rreth 5.8 miliardë euro, sipas të dhënave të publikuara nga shoqata lokale e siguruesve (TSB, *Insurance Association of Turkey*). Segmenti i Jo-Jetës ka kontribuar me 85.7% të këtyre të ardhurave, ndërsa segmenti Jetë për pjesën tjetër, prej 14.3%. Rritjen më të madhe në bazë vjetore e ka patur segmenti Jetë, me 47.6%, ndërsa segmenti i Jo-Jetës pësoi një rritje prej 7.6%. Në segmentin e Jo-Jetës duhet përmendur rënia me 10.7% e të ardhurave nga MTPL, për shkak të zbatimit të një çmimi tavan për primet, duke nisur nga mesi i muajit prill.

## Vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore

[www.xprimm.com](http://www.xprimm.com)

Në gjashtëmujorin e parë të vitit 2017, tregu i sigurimeve në vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore shënoi një rritje vjetore me 12.84%, ose me 18.28 miliardë euro, duke ndikuar edhe në rritjen e përgjithshme ekonomike të rajonit. Dëmet e paguara shënuan gjithashtu rritje, duke arritur në 10.64 miliardë euro, ose 10.75% më shumë sesa 6-mujori i parë i vitit 2016. Primet e sigurimit të Jetës shënuan rritje prej 7%, ose me 6.48 miliardë euro, ndërsa segmenti i Jo-Jetës u rrit me 16.3%, ose me 11.8 miliardë euro. Linja e sigurimit motorik, në veçanti MTPL shënoi rritjen më të madhe në segmentin e Jo-Jetës. Polonia shënoi rritjen më të madhe mes vendeve të Evropës Qendrore dhe Lindore, e ndjekur nga Republika Çeke, Hungaria, Sllovenia e Rumania.



**AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE**

Për informacion të mëtejshëm  
ju lutemi na kontaktoni:

Rr. "Dora D'Istria", Nr. 10 , P.O.Box 8363, Tiranë  
Tel: +355 42 251 355/6 | Fax: +355 42 250 686  
amf@amf.gov.al | www.amf.gov.al